# DËSHMI ARKIVI

**A-454330**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | BE kërkon kufizime më të rrepta moshe për rrjetet sociale |
| ADRESA | `https://dosja.al/bota/be-kerkon-kufizime-me-te-rrepta-moshe-per-rrjetet-sociale-i514788` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 08:41:26 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 08:24:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d4abae8bd515a4108339ac1164c6e5f7a6d97acbe117d01b0c467fa35cf22de2` |
| TEKSTI | `b8d6e714cbca4777155730648b3bb1643de6b8fefd03cbb8bb5d46352ff5057f` |
| PAMJA | `73bc5f1660846a27413ddfc5684344c08d82c9f47ffbd0ed2ee7405e687e9b8b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `79e612ac388c73c45a3d0f33250d97a7c5f2a04bf3bd1874072d5d132e39bf76` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `35ab8d40f1b8a4415a5ce6150a0f35dfc65972e0cbe708d5f8ac326bd7570577` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/79e612ac388c73c45a3d0f33250d97a7c5f2a04bf3bd1874072d5d132e39bf76`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Bota

# BE kërkon kufizime më të rrepta moshe për rrjetet sociale

Masa vjen pas propozimeve të ngjashme të paraqitura në Australi, Mbretërinë e Bashkuar, Kinë, Indi, Turqi dhe në disa vende evropiane, si përgjigje ndaj shqetësimeve në rritje për ndikimin që mediat sociale mund të kenë në shëndetin mendor të fëmijëve.

18 Shtator 2026, 10:24
Nga E.d



Foto ilustruse

Ursula von der Leyen, presidente e Komisionit Evropian, prezantoi një plan që synon t'i mbrojë fëmijët nga rreziqet që lidhen me disa platforma të mediave sociale. Nisma synon të ndalojë aksesin në platforma si Facebook, TikTok dhe Instagram për fëmijët nën moshën 13 vjeç.

"Ajo për të cilën tashmë kemi konsensus është se duhet të ketë një moshë minimale kur fëmijët mund t'u bashkohen mediave sociale", tha von der Leyen, duke kërkuar "kufizime të përshtatshme për moshën".

Masa vjen pas propozimeve të ngjashme të paraqitura në Australi, Mbretërinë e Bashkuar, Kinë, Indi, Turqi dhe në disa vende evropiane, si përgjigje ndaj shqetësimeve në rritje për ndikimin që mediat sociale mund të kenë në shëndetin mendor të fëmijëve.

"Sot, fëmijët tanë po ndërveprojnë me disa nga teknologjitë më të sofistikuara që janë krijuar ndonjëherë, dhe ato nuk janë projektuar duke pasur në qendër mirëqenien dhe zhvillimin e tyre", tha von der Leyen gjatë një konference për shtyp.

Reforma e propozuar për Ligjin Evropian për Mbrojtjen e Fëmijëve "do të vendosë kufij të qartë në botën digjitale, ashtu siç bëjmë çdo ditë në botën reale", shtoi ajo.

**A bien ligjet evropiane në kundërshtim me njëri-tjetrin?**

Organizata jofitimprurëse CCIA Europe, e cila përfaqëson kompani të mëdha teknologjike në Evropë, ndër të cilat edhe Google dhe Meta, paralajmëroi për rreziqe të mundshme ndaj privatësisë që mund të lindin nga ky propozim dhe vuri në dukje se ai mund të bierë në kundërshtim me kërkesat e ligjeve të tjera të Bashkimit Evropian.

"Mbledhja në një shkallë të tillë e të dhënave për moshën, dokumenteve të identitetit dhe informacioneve lidhur me fëmijët dhe prindërit ose kujdestarët e tyre do të krijonte pa dyshim një objektiv tërheqës për kriminelët

kibernetike", tha drejtori i CCIA Europe, Daniel Friedlaender.

"Ligji për Fëmijët krijon mbivendosje ligjore dhe dublikim të rregulloreve, gjë që në fund dobëson mbrojtjen e fëmijëve dhe të konsumatorëve", shtoi ai.

**Më shumë kontroll nga prindërit dhe rregulla më të rrepta**

Propozimi i Ursula von der Leyen do t'u japë prindërve më shumë kontroll mbi llogaritë e të rinjve të moshës 13 deri në 15 vjeç. Nisma do të diskutohet gjatë muajve të ardhshëm nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe Parlamenti Evropian, përpara se të mund të shndërrohet në ligj.

Llogaritë në rrjetet sociale, shërbimet e videove, videolojërat online dhe chatbot-et të destinuara për përdorues nën moshën 18 vjeç do t'u nënshtrohen një sërë rregullash më të rrepta.

Këto përfshijnëndalimin e funksioneve që konsiderohen krijuese të varësisë, si lëvizja e pafundme e përmbajtjes (infinite scrolling) dhe fillimi automatik i videove (autoplay). Propozimi gjithashtu synon të kufizojë rekomandimet e drejtuara nga algoritmet, profilizimin e personalizuar, mekanizmat e angazhimit të bazuar në shpërblime dhe kontaktet e padëshiruara nga persona të panjohur.

Një tjetër kërkesë e Parlamentit Evropian është që platformat të detyrohen të zbatojnë dizajne dhe algoritme të sigurta për fëmijët, si edhe të ofrojnë mjete të thjeshta për kontrollin prindëror.

Përveç kësaj, kompanitë e mëdha të teknologjisë do të duhet të forcojnë sistemet e verifikimit të moshës për këdo që dëshiron të hapë një llogari. Kompanitë që nuk respektojnë këto rregulla mund të përballen me gjoba deri në 6% të të ardhurave të tyre vjetore globale. Ato gjithashtu do të detyrohen të investojnë më shumë burime në mbikëqyrjen dhe moderimin e përmbajtjeve./DW

ursula von der leyen | fëmijët | platforma sociale

## Sondazh

Poll

Bota

18 Shtator 2026, 10:05

## Friedrich Merz: A do ta braktisë CDU-ja kancelarin?

Hendrik Wüst dhe Friedrich Merz Në fillim të kësaj jave, kancelari Friedrich Merz (CDU) ndodhej në Rovaniemi, n&e...

"Perceptimi si një vend i sigurt po zbehet"/ Pse bankat evropiane po e heqin arin e tyre nga SHBA-ja?

Bota

18 Shtator 2026, 10:01

BOTA 18 SHTATOR 2026, 07:15

Hetimet për nënshkrimet e partisë/ Parlamenti Europian i heq imunitetin eurodeputetes greke Afroditi Latinopoulou

## më të klikuarat

**Falsifikime dhe shpërdorim detyre/ Pezullohen dy zyrtarë në Tiranë, shpallet në kërkim shqiptaro-izraeliti me tre identitete**

**Shkatërrohet organizata shqiptare që frymëzoi serialin e famshëm 'Marbella'/ Kapen 2.7 ton kokainë, sekuestrohen dy armë zjarri dhe 29 mjete luksoze, 15 persona të arrestuar (VIDEO)**

**Përdhunoi 32-vjeçaren dhe i plagosi babain, "arrest me burg" për dajën e Zegjine Çaushit**

**Gjykata Speciale e dënoi me 25 vite burg/ Reagon Thaçi: Mirënjohje popullit të Kosovës për mbështetjen, do ta apelojmë vendimin e Hagës**

## insights

Auron Janku

**Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë**

Ola Xama

**Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen**

Idriz Konjari

**Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?**

Bledian Koka

**Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?**

## Moti

Powered by tomorrow.io

### Rusët votojnë në zgjedhjet e para parlamentare që nga nisja e pushtimit të Ukrainës më 2022

Bota

18 Shtator 2026, 09:58

### VIDEO/ Shirat e rrëmbyeshëm përfshijnë Spanjën, përmbytjet paralizojnë Barcelonën dhe Valencian

Bota

18 Shtator 2026, 07:42

### Rriten tensionet në Lindjen e Mesme/ Kolonët izraelitë u vënë zjarrin ullinjve palestinezë në Bregun Perëndimor

Bota

18 Shtator 2026, 07:36

Bota

18 Shtator 2026, 07:24

# Lufta e çipave IA/ Huawei kufizon shitjet jashtë Kinës, kërkesa tejkalon prodhimin

Foto ilustruse Huawei po përballet me një kërkesë që po tejkalon kapacitetet e saj të prodhimit për pajisjet e intelige...

### Hetimet për nënshkrimet e partisë/ Parlamenti Europian i heq imunitetin eurodeputetes greke Afroditi Latinopoulou

Bota

18 Shtator 2026, 07:15

### OKB: Çdo sulm ndaj të drejtave të komunitetit LGBTI+ në Turqi prek të drejtat e njeriut

Bota

17 Shtator 2026, 22:45

### Të nominuarit për ambasadorë të SHBA-së në Serbi e Bosnje: Stabiliteti rajonal dhe frenimi i ndikimit rus e kinez, synimet kryesore

Bota

17 Shtator 2026, 22:31

### Kundërofensiva ukrainase “shpartallon” forcat ruse

Bota

17 Shtator 2026, 21:26

MË SHUMË



## Rama për pagat e magjistratëve: Askush nuk mund t’i diktojë Kuvendit kur të mblidhet



Rama për pagat e magjistratëve: Askush nuk mund t’i diktojë Kuvendit kur të mblidhet



Rama: Lëvizjet e koordinuara mes shoqatave dhe gjyqësorit dëmtojnë Republikën e Shqipërisë



"SPAK dhe GJKKO janë dy suksese të reformës në drejtësi"/ Rama: KLP dhe KLGJ kanë falimentuar



Rama për opozitën: Të të përzënë nga protesta quhet “amanet mushkat, se kuajt ikën”

Shiko video te tjera

KTHEHU NE KRYE


Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [email protected]

KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MUNDESUAR NGA Mediadesk





**Drejtor: Enton Abilekaj**

**Kryeredaktor: Izmir Akulli**

**Gazetarë:**
Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.